
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë . . 2025

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT MBI PËRFITIMIN NGA
PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË NË
TREGUN E LIRË”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligji nr 22/2018, ”Për Strehimin Social”, Neni.15 pika (3) njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kolonjë. Këshillit Bashkiak në mbledhjen e dates ___/12/2025

1.Miratimin e Sistemit të Pikëzimit mbi përfitimin nga programi i strehimit social “Për subvencionimin e qirasë në tregun e lire”, bazuar në ligjin nr 22/2018, ”Për Strehimin Social” Shtojca (a) bashkangjitur këtij project-vendimi.

2.Ngarkohet Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.

3.Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e insitucionit të Prefektit të Qarkut Korçë.


Konc: Spec E. Xhelollari
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.I.lifo



**KRYETARI
ERION ISAI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**N/KRYETAR
PETRO RISTO**



Adresa: Sheshi “Rifindja”, 7401, Ersekë, Kolonjë, www.kolonja.gov.al, email: info@kolonja.gov.al

Shtojca a) 1.Sistemi i pikëzimit të programit të “Subvencionimit të qirasë në tregun e lirë”.

	KRITERET E PIKEZIMIT Programi i subvencionimit të qirasë në tregun e lire.	PIKËT
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
A	Nuk disponon apartament në pronësi.	10
B	Familje që banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi/ ose në banesa me rrezik shembje.	8
C	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi administrativ apo gjyqësor sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	7
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
A	Familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna.	7
B	Familjet me më shumë se katër fëmijë.	6
C	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit.	5
Ç	Familje të reja ku çifti bashkëshortëve ka moshe të përbashkët totale deri 60 vjeç.	7
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Persona me aftësi të kufizuar/ invalidët e punës.	6
B	Viktima të dhunës në familje/ viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit/të miturit, 14-18 vjeç, dhe të rinjtë, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin;	5
C	Individët me statusin e jetimit.	4
Ç	Komuniteti Rom dhe Egjipian/ individët, që i përkasin komunitetit LGBTI.	5
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë/ punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë/ punonjësit e repartit RENE/ punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	3
E	Emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit.	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare.	13
B	Të ardhura deri 70%- 100% të të ardhurave mesatare.	8
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare.	4
1,5	KRITER	
A	Përfitojnë familjet që kanë më pak se tre vjet në bonus	
	TOTALI I PIKËVE	100

Mënyra e vlerësimit dhe llogaritja:

Shënim:


-Nuk mund të mbliidhen pikët brenda për brenda një kriteri nga A deri tek pika e fundit për:

1.1. Kushtet e Strehimit , 1.2. Kushtet Familjare, 1.4. Kushtet Ekonomike.

Në rast se një aplikant deklaron ose plotëson më shumë se sa një kriter brenda këtyre ndarjeve merret parasysh kriteri me më shumë pikë.

-Pikët maksimale që mund të marrë një aplikant janë 100, për aplikantët të cilët janë me pikë të barabarta vlerësohet përbërja familjare, numri i pjesëtarëve dhe kushtet social ekonomike, ku përparësi kanë familjet me shumë fëmijë, apo që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, renditje e cila vendoset me vendim të këshillit bashkiak.

Konc: Spec E. Xhelollari
Konfirmoi: Drejtori D.G.J.P.P O.Lifo



**KRYETARI
ERION ISAI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**N/KRYETAR
PETRO RISTO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr 132 Prot

Ersekë, më 12 . 12 .2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT MBI PËRFITIMIN NGA
PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË NË
TREGUN E LIRË”

Të nderuar,

	KRITERET E PIKËZIMIT Programi i subvencionimit të qirasë në tregun e lire.	PIKËT
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
A	Nuk disponon apartament në pronësi.	10
B	Familje që banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi/ ose në banesa me rrezik shembje.	8
C	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi administrativ apo gjyqësor sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	7
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
A	Familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna.	7
B	Familjet me më shumë se katër fëmijë.	6
C	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit.	5
Ç	Familje të reja ku çifti bashkëshortëve ka moshë të përbashkët totale deri 60 vjeç.	7
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Persona me aftësi të kufizuar/ invalidët e punës.	6
B	Viktima të dhunës në familje/ viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit/të miturit, 14-18 vjeç, dhe të rinjtë, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin;	5

C	Individët me statusin e jetimit.	4
Ç	Komuniteti Rom dhe Egjiptian/ individët, që i përkasin komunitetit LGBTI.	5
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë/ punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë/ punonjësit e repartit RENEA/ punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	3
E	Emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit.	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare.	13
B	Të ardhura deri 70%- 100% të të ardhurave mesatare.	8
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare.	4
1,5	KRITER	
	Përfitojnë familjet që kanë më pak se tre vjet në bonus	
	TOTALI I PIKËVE	100

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligji nr 22/2018,”Për Strehimin Social”, Neni.15 pika (3) njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kolonjë, I kërkohet Këshillit Bashkiak të miratojë sistemin e pikëzimit, mbi përfitimin nga program I strehimit social “Për subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, sipas shtojcës më poshtë:

Mënyra e vlerësimit dhe llogaritja:

Shënim:

-Nuk mund të mblidhen pikët brenda për brenda një kriteri nga A deri tek pika e fundit për:

1.1. Kushtet e Strehimit , 1.2. Kushtet Familjare, 1.3. Kushtet Ekonomike.

Në rast se një aplikant deklaron ose plotëson më shumë se sa një kriter brenda këtyre ndarjeve merret parasysh kriteri me më shumë pikë.

-Pikët maksimale që mund të marrë një aplikant janë 100, për aplikantët të cilët janë me pikë të barabarta vlerësohet përbërja familjare, numri i pjesëtarëve dhe kushtet social ekonomike, ku përparësi kanë familjet me shumë fëmijë, apo që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, renditje e cila vendoset me vendim të këshillit bashkiak.

Miratimi I sistemit të pikëzimit do të shërbejë në trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe do të jetë në transparencë për të gjitha kategoritë përfituese në respektim të kriterëve prioritarë.

Ju faleminderit!

Konc: Spec E. Xhelollari
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P P O.Lito



**KRYETARI
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETAR
PETRO RISTO**